



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit



**Programi Buxhetor
Afatmesëm
2018- 2020**

TABELA E PËRMBAJTJES

| | |
|---|------------|
| HYRJE | 2 |
| A.1 ROLI I PROGRAMIT BUXHETOR AFATMEËM | 2 |
| A.2 PROGRAMI BUXHETOR AFATMEËM DHE STRATEGJIA KOMBËTARE PËR ZHVILLIM DHE INTEGRIM | 2 |
| A.3 PROCESI I PËRGATITJES SË PBA 2018 – 2020 | 3 |
| <i>A.3.1 Rishikimi i Politikës së Programit (RPP)</i> | 3 |
| <i>A.3.2 Planifikimi i Shpenzimeve dhe Investimeve të Programit (PSHIP)</i> | 4 |
| <i>A.3.3 Roli i Ministrisë së Financave në procesin e PBA</i> | 5 |
| <i>A.3.4 Roli i Komitetit të Planifikimit Strategjik</i> | 5 |
| <i>A.3.5 Buxhetimi Gjinor</i> | |
| B. KUADRI MAKROEKONOMIK DHE FISKAL PËR PERIUDHËN 2018-2020 | Error! Boo |
| C. KËRKESAT BUXHETORE AFATMESME SIPAS PROGRAMEVE TË MINISTRIVE TË LINJËS | 15 |
| C.1 MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL | 17 |
| C.2 MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË | 72 |
| C.3 MINISTRIA E FINANCave DHE EKONOMISË | 105 |
| C.4 MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË | 181 |
| C.5 MINISTRIA E KULTURËS | 206 |
| C.6 MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE | 230 |
| C.7 MINISTRIA E DREJTËSISË | 242 |
| C.8 MINISTRIA PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME | 258 |
| C.9 MINISTRIA E BRENDSHME | 286 |
| C.10 MINISTRIA E MBROJTJES | 305 |
| C.11 MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT | 357 |
| | 571 |
| <i>Aneksi 1: Tavanet e Shpenzimeve Buxhetore 2018-2020 në nivel programi dhe grup artikujsh për Ministrinë e Linjës</i> | 572 |

PËRMBLEDHJE

Dokumenti i Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2018 – 2020 përbën finalizimin e procesit të përgatitjes së kërkesave buxhetore afatmesme 2018 – 2020, proces ky i iniciuar përmes vendimeve të Këshillit të Ministrave nr.47, datë 25.01.2017 “Për miratimin e kuadrit makroekonomik e fiskal për periudhën 2018-2020” dhe vendimit nr.197, datë 15.03.2017 “Për miratimin e taveve përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm 2018-2020”.

Si çdo vit, i gjithë procesi është drejtuar dhe koordinuar nga Grupi për Manaxhimin Strategjik (GMS), i cili është ngritur në çdo njësi të qeverisjes qendrore në bazë të Urdhrit të Kryeministrit nr.78, datë 08.05.2006, “Për krijimin e grupeve ministore të punës për Strategji, Buxhet dhe Integrim, ‘GSBI’”, i ndryshuar, ku një rol të veçantë ka luajtur koordinatori i GMS (Nëpunësi Autorizues/Sekretari i Përgjithshëm) në çdo njësi të qeverisjes qendrore. Në mënyrë të ngjashme, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 23, datë 22.11.2016 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, dhe udhëzimit nr.10, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e PBA 2018 – 2020 ” dhe udhëzimit plotësues nr.10/3, datë 13.7.2017 është drejtuar dhe organizuar ky proces edhe në institucionet e tjera buxhetore.

Dokumenti i PBA 2018 – 2020 paraqet në detaje qëllimet, objektivat dhe produktet e programeve të secilës prej Ministrive të Linjës, për vitet 2018, 2019 dhe 2020. Kështu, ky dokument ka mundur të realizojë për një kuadër afatmesëm lidhjet mes qëllimeve dhe objektivave të politikave, me shpërndarjen e burimeve buxhetore, përkatësisht në nivel programi.

Është e rëndësishme përt’u theksuar fakti se, me rritjen progresive të vëmendjes kushtuar procesit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2018 – 2020, kapaciteti i manaxhimit po përmirësohet vazhdimisht me kalimin e kohës. Gjithashtu, Sistemi i Planifikimit të Integruar dhe veçanërisht Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, janë bazat e forcimit të vazhdueshëm të procesit të PBA, nëpërmjet sigurimit të informacionit të nevojshëm në nivel strategjik të politikave.

Në vijim, dokumenti i Programit Buxhetor Afatmesëm, 2018– 2020 është i strukturuar në tre kapituj:

- **Kapitulli i Parë** përshkruan rolin e PBA, si një instrument i manaxhimit të shpenzimeve publike, pjesë përbërëse e Sistemit të Planifikimit të Integruar, si dhe termat kohorë që procesi i PBA ndjek gjatë vitit buxhetor.
- **Kapitulli i Dytë** përshkruan Kuadrin Makroekonomik dhe Fiskal për periudhën 2018 – 2020.
- **Kapitulli i Tretë** paraqet në mënyrë të përmbledhur informacionin e siguruar nga Ministritë e Linjës lidhur me Kërkesat Buxhetore Afatmesme 2018 – 2020 dhe konkretisht qëllimet e politikës, objektivat dhe produktet për secilin prej programeve të tyre për vitet 2018, 2019 dhe 2020.

Gjithashtu, në këtë dokument përfshihen edhe 1 aneks shoqërues i strukturuar si më poshtë:

Aneksi 1: Tavanet e shpenzimeve buxhetore 2018– 2020, në nivel programi dhe grup artikujsh për Ministritë e Linjës;

Hyrje

A.1 Roli i Programit Buxhetor Afatmesëm

1. Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është një instrument operacional për manaxhimin e shpenzimeve publike dhe një komponent kyç i Sistemit të Planifikimit të Integruar. Ai është rezultat i dy proceseve: Rishikimit të Politikave dhe Planifikimit të Shpenzimeve dhe Investimeve të Programit. Planet e shpenzimeve hartohen nga njësitë e qeverisjes qendrore brenda burimeve që Qeveria ka në dispozicion. Ky dokument përdoret për të informuar Kuvendin e Shqipërisë dhe publikun e gjerë lidhur me planet e shpenzimeve të Qeverisë për tre vitet e ardhshme, të cilat do të çojnë në arritjen e objektivave politike të Qeverisë. Ai përcakton kontekstin afatmesëm të Buxhetit Vjetor.
2. Qëllimet kryesore të PBA janë:
 - *Inkurajimi i efektivitetit, efikasitetit dhe ekonomisë në kryerjen e shpenzimeve publike;*
 - *Lidhje e drejtpërdrejtë ndërmjet prioriteteve strategjiko-politike të Qeverisë me shpërndarjen e burimeve publike dhe kryerjen e shpenzimeve publike;*
 - *Promovimi i disiplinës fiskale duke mundësuar që shpenzimet publike të planifikohen brenda një kuadri realist makroekonomik dhe fiskal;*
 - *Zgjerimi i vizionit të procesit buxhetor duke siguruar që programet e shpenzimeve të planifikohen në një periudhë afatmesme (3- vjeçare).*

Dokumenti i PBA hartohet nga Ministria e Financave dhe i jep mundësinë Këshillit të Ministrave për të zhvilluar një kuadër të qartë burimesh brenda periudhës afatmesme, që do të shërbejë si bazë për planifikimin e shpenzimeve publike korrente dhe kapitale.

Gjithashtu, ai i shërben njësisë të qeverisjes qendrore dhe fondeve speciale të tyre pasi mundëson përcaktimin prej tyre të politikave dhe programeve në një strukturë koherente, si dhe mundësinë për të përcaktuar kostot dhe prioritetet e tyre brenda kontekstit të burimeve të disponueshme, në mënyrë që burimet financiare të mund të alokohen tek programet prioritare në periudhën afatmesme.

Duhet theksuar gjithashtu që procesi i hartimit të PBA është i orientuar mbi bazën e performancës. Përparësitë e kësaj mënyre të re të konceptimit të planifikimit të shpenzimeve konsistojnë në përfitim e:

- *Kontributit të qartë të produkteve në përmbushjen e objektivave të politikës;*
- *Produkteve të matshme;*
- *Aktivitetëve të kostueshëm.*

Procesi i hartimit të dokumentit të PBA u realizua nga një bashkëpunim i ngushtë ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me Departamentin e Programimit të Zhvillimit të Financimeve dhe të Ndihmës së Huaj, në Kryeministri.

A.2 Programi Buxhetor Afatmesëm dhe Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, me një horizont planifikimi prej 7 vitesh, përcakton strategjitë dhe synimet afatshkurtra dhe afatgjata për të gjithë sektorët, bazuar në një vizion kombëtar. Ky program do të shërbejë edhe arritjes së aspiratave të SKZHI-së për Integrimin Europian.

DOKUMENTI I PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2018– 2020

Për procesin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2018 – 2020, elementi strategjik i PBA u siguroi nëpërmjet konsultimit të strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale përgjatë procesit të Rishikimit të Politikës së Programit – përcaktimi i qëllimeve dhe objektivave për çdo program buxhetor të ministrive të linjës.

A.3 Procesi i Përgatitjes së PBA 2018– 2020

Tabela 1, paraqet në mënyrë të përmblendhur hapat kryesorë në procesin e përgatitjes së PBA 2018 – 2020, të ndërmarrë në përputhje me kalendarin e Sistemit të Planifikimit të Integruar dhe kalendarin e Manaxhimit të Shpenzimeve Publike për vitin 2017, të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.6, datë 11.1.2016.

Tabela 1 Fazat e Përgatitjes së PBA-së

| FAZAT | KOHA | PERSHKRIMI |
|---|---------------|---|
| 1. Kuadri makroekonomik, vendosja e prioriteteve dhe përgatitja e tavanëve të PBA-së për çdo njësi të qeverisjes qendrore dhe fondet speciale. | Tremujori I | <ul style="list-style-type: none"> Përgatitja e tavanëve të përgjithshme dhe vendosja e treguesve makroekonomikë përmes parashikimit makroekonomik Identifikimi i prioriteteve të politikave dhe zërave me ndikim të rëndësishëm në shpenzime e të ardhura (pagat, transfertat vendore, programet e reja, projektet kryesorë të investimeve publike) Vendosja e tavanëve përgatitore të PBA Përgatitja e Udhëzimit për Përgatitjen e PBA. |
| Qeveria miraton parashikimin Makro Ekonomik dhe Fiskal, tavanet e përgjithshme dhe tavanet përgatitore të PBA 3-vjeçare për çdo njësi të qeverisjes qendrore dhe fondet speciale të tyre | | |
| 2. Rishikimi i Politikës së Programit (RPP) | Tremujori II | <ul style="list-style-type: none"> Njësitë e Qeverisjes Qendrore përcaktojnë politikat për çdo program dhe identifikojnë qëllimet dhe objektivat e programit |
| 3. Planifikimi i Shpenzimeve dhe Investimeve të Programit (PSHIP) | Tremujori II | <ul style="list-style-type: none"> Brenda tavanëve të miratuara, Njësitë e Qeverisjes Qendrore zhvillojnë PSHIP duke identifikuar produktet dhe duke i kostuar aktivitetet në bazë të fondeve në dispozicion për çdo program |
| Qeveria miraton projekt -dokumentin e PBA | | |
| 4. Përgatitja e Buxhetit | Tremujori III | <ul style="list-style-type: none"> Përgatitja e Udhëzimit Plotësues për Përgatitjen e PBA Njësitë e Qeverisjes Qendrore paraqesin kërkesat buxhetore afatmesme të rishikuara |
| Qeveria miraton projektin e PBA të rishikuar dhe projektligjin e buxhetit vjetor dhe i dërgon në Kuvend përkatësisht për informim dhe miratim | | |
| 5. Shqyrtimi në Kuvend | Tremujori IV | <ul style="list-style-type: none"> Shqyrtimi dhe miratimi i ligjit vjetor të buxhetit nga Kuvendi |

Shënim: Dokumenti përfundimtar i PBA publikohet në fillim të vitit pasardhës pas miratimit të ligjit vjetor të buxhetit nga Kuvendi

A.3.1 Rishikimi i Politikës së Programit (RPP)

Nevoja kryesore për një menaxhim efektiv të financave publike është përcaktimi i qartë i politikave. Për politikën e reja kjo mund të arrihet nëpërmjet zbatimit të një procesi të mirë të përcaktimit të politikave, domethënë nëpërmjet përmirësimit të hartimit të politikave.

Procesi i PBA-së merr një rëndësi parësore në përpjekjet e qeverisë për të lidhur buxhetin vjetor me politikën e tij. Për të arritur këtë, politikat duhet të jenë të qarta, të kuptueshme dhe të rishikohen rregullisht nëpërmjet një procesi të rishikimit të politikës së programit, i cili është i integruar me procesin e planifikimit të shpenzimeve dhe investimeve, përcaktimit të kostove dhe përgatitjes së buxhetit.

A.3.2 Planifikimi i Shpenzimeve dhe Investimeve të Programit (PSHIP)

Planifikimi i Shpenzimeve dhe Investimeve të Programit është pjesë e planifikimit strategjik dhe pason Rishikimin e Politikës së Programit. Ai përfaqëson pjesën kryesore të procesit të përgatitjes së PBA. PSHIP ndërmerret në kontekstin e politikës makroekonomike dhe veçanërisht të nevojës për stabilitet fiskal.

Ai realizohet gjithashtu në kontekstin e prioritetëve strategjike të Qeverisë dhe të qëllimeve dhe objektivave të politikës të përcaktuara për çdo sektor, domethënë, nëpërmjet Rishikimit të Politikës së Programit, PSHIP reflekton mënyrën se si Qeveria dëshiron t'i alokojë burimet e saj për secilin sektor.

Një hap i rëndësishëm për të garantuar që procesi i PSHIP të jetë në përputhje me kuadrin makroekonomik e fiskal dhe prioritetet strategjike të Qeverisë është vendosja e taveve të shpenzimeve, që përbën kufirin maksimal që mund të shpenzohet ose të planifikohet për t'u shpenzuar, për një qëllim të caktuar. PSHIP ndërmerret nga ministritë e linjës duke përdorur sistemin e informatizuar të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë për Planifikimin e Shpenzimeve dhe Investimeve të Programeve. Për njësitë e qeverisjes qendrore që nuk kanë akses në sistemin e informatizuar, planifikimi i shpenzimeve mundësohet nëpërmjet formateve përkatëse të përcaktuara në udhëzimin e përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm.

A.4 Roli i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në procesin e PBA

Roli i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë përgjatë procesit të PBA është kryesor dhe shumë i rëndësishëm. Ministria e Financave dhe Ekonomisë gjatë fazës së Rishikimit të Politikës së Programit, duhet të sigurojë që politikat, objektivat dhe qëllimet janë të përcaktuara qartë dhe se programet buxhetore dhe rezultatet e synuara do të plotësojnë objektivat dhe qëllimet e politikës në një mënyrë që krijon vlerë për para që do të thotë përdorim të shpenzimeve publike në mënyrë ekonomike, eficiente dhe efektive.

Ndërsa, roli i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në fazën e Planifikimit të Shpenzimeve dhe Investimeve të Programit është i dyfishtë.

- i) Dërgon propozime për Tavanet e Përgjithshme të Shpenzimeve dhe Tavanet Përgatitore të PBA-së në Këshillin e Ministrave;
- ii) Analiza dhe vlerësimi nëse njësitë e qeverisjes qendrore po arrijnë eficiencën, efektivitetin dhe ekonominë në përdorimin e fondeve buxhetore, gjë e cila mbahet në konsideratë gjatë propozimit të Taveve Përgatitore të PBA-së në Këshillin e Ministrave.

A.5 Roli i Komitetit të Planifikimit Strategjik

Komiteti i Planifikimit Strategjik është një strukturë e krijuar pranë Këshillit të Ministrave, e cila kryesohet nga Kryeministri. Roli i këtij Komiteti është thellësisht koordinues dhe vendimmarrës, pasi të gjitha propozimet e rëndësishme që kanë të bëjnë me Sistemin e Planifikimit të Integruar në përgjithësi, dhe Programit Buxhetor Afatmesëm në veçanti, kalojnë detyrimisht për shqyrtim pranë këtij Komiteti përpara se të marrin miratimin përfundimtar pranë Këshillit të Ministrave.

Në procesin e përgatitjes së PBA, Komiteti i Planifikimit Strategjik dhe Këshilli i Ministrave luajnë një rol parësor në drejtim të miratimit të një sërë etapash të rëndësishme të tilla si:

- *Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal për periudhën e PBA;*
- *Tavanet Përgatitore dhe Përfundimtare të PBA;*
- *Kalendari i Sistemit të Planifikimit të Integruar;*
- *Projekt Dokumentin e PBA;*
- *Dokumentin e PBA të rishikuar.*

A.6 Buxhetimi Gjikor

Bazuar në Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Udhëzimin të Ministrit të Financave nr.23 datë 22.11.2016 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, janë identifikuar 21 **programe buxhetore** gjatë fazës së I të përgatitjes së dokumentit të PBA 2018-2020 që përfshijnë buxhetimin gjikor në kërkesat e tyre për PBA. Më konkretisht:

1. Programi “*Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor*”, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave (Informimi dhe këshillimi që i ofrohet fermereve femra)
2. Programi “*Tregu i Punës*”, Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë (Trainimi profesional i femrave si dhe skemat e nxitjes së punësimit që mbështesin punë-kërkueset femra).
3. Programi “*Përfshirja Sociale*”, Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë (politika që mbështesin çështjet gjinore)
4. Programi “*Përkujdesi Social*” Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë (mbështetje financiare dhe shërbime për femrat në vështirësi financiare, të abuzuara, si dhe pjesë e grupeve sociale të marxhinalizuara)
5. Programi “*Mbështetja Institucionale për Procesin e Integritetit*”, Ministria e Integritetit European (ofrimi i të drejtave dhe mundësive të barabarta në aksesin e informacionit për proceset e integritetit në BE)
6. Programi “*Arti dhe Kultura*”, Ministria e Kulturës (ofrimi i mundësive/të drejtave të barabarta në përfitimin prej programeve specifike të mbështetjes së artit dhe kulturës)
7. Programi “*Mbështetja për Zhvillim Ekonomik*”, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (skema të ndryshme të mbështetjes financiare për sipërmarrëset femra)

8. Nën-programi *“Shërbimet Mbështetëse”*, Programi *“Policia e Shtetit”*, Ministria e Punëve të Brendshme (ofrimi i mundësive/kushteve të barabarta të punësimit në trupën policore, programet/aktivitetet që mbeshtesin sigurinë dhe mbrojtjen e femrave).
9. Nën-Programi *“Hetimi i Krimeve”* – Programi *“Policia e Shtetit”*, Ministria e Punëve të Brendshme (Parandalimi e lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore në tërësi/gjinisë femërore ne veçanti)
10. Nën-Programi *“Siguria Publike”* – Programi *“Policia e Shtetit”*, Ministria e Punëve të Brendshme (Parandalimi i rasteve të dhunës në familje nëpërmjet rritjes së numrit të masave të menjëhershme mbrojtëse për gratë dhe vajzat e dhunuara)
11. Programi *“Fonde për Shkencën”* – Ministria e Arsimit dhe Sporteve (Mbështetje e diferencuar për kërkueset femra që aplikojnë)
12. Programi *“Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi”* – Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (Monitorimi dhe parandalimi i rasteve të diskriminimit të grave në fusha të ndryshme të aktivitetit publik dhe privat)
13. Programi *“Sistemi i Burgjeve”* – Ministria e Drejtësisë (sigurimi i kushteve optimale për të dënuarat femra, rritja e aftësive të tyre profesionale me synim ri-integrimin e shpejtë të tyre në shoqëri)
14. Programi *“Shërbimi i Përmbartimit Gjyqësor”* – Ministria e Drejtësisë (Sigurimi i ekzekutimit të plotë të çdo urdhër mbrojtjeje që kanë si objekt gratë)
15. Programi *“Planifikimi Urban dhe Strehimi”* – Ministria e Zhvillimit Urban (Sigurimi i strehimit të familjeve një-prindërore dhe grave të dhunuara nëpërmjet skemave të ndryshme të strehimit)
16. Programi *“Shëndeti Publik”* – Ministria e Shëndetësisë (Zgjerimi i shërbimit të depistimit të kancerit të gjirit)
17. Programi *“Shërbimet e Kujdesit Parësor”* – Ministria e Shëndetësisë (Zvogëlimi i vdekshmërisë foshnjore dhe e nënave)
18. Programi *“Shërbimet e Kujdesit Dytësor”* – Ministria e Shëndetësisë (Ofrimi i shërbimeve cilësore spitalore për pacientet femra)
19. Programi *“Administrimi i pyjeve”* – Ministria e Mjedisit (Rritjen e aksesit të grave vendim-marrëse në Shoqatat Pyjeve dhe Kullotave dhe përmirësimin e mundësive për gratë dhe të rinjtë në aplikimet për grantet konkurruese në fushën e menaxhimit të pyjeve)
20. Programi *“Shërbimi i provës”* – Ministria e Drejtësisë (Aplikimi i programeve specifike për grupe të veçanta apo individëve për të adresuar në mënyrë efektive problemin e recidivizmit)
21. Programi *“Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi”* – Ministria e Drejtësisë (Ofrimi i shërbimeve këshillimore, përfaqësimit dhe të mbrojtjes në procesin penal nga ana e Komisionit Shtetëror të Ndhmës Juridike për gratë në nevojë)

DOKUMENTI I PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2018–2020

Proçesi i përfshirjes efektive të buxhetimit gjinor në kërkesat buxhetore të ministrive të linjës dhe institucioneve të tjera buxhetore do të vijojë në mënyrë aktive në vazhdimësi, nëpërmjet dhe asistencës së zyrës së UN Women në Shqipëri, duke u fokusuar sidomos në përsosjen e mekanizmave të monitorimit të ecurisë së politikave gjinore të identifikuara nga programet e sipërcituara, ashtu edhe në përmirësimin e cilësisë së treguesve të performancës për këto programe.

B.1 Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal për Periudhën 2018–2020

Kuadri Makroekonomik e Fiskal (KMF) fillestar për periudhën 2018-2020¹ është pjesë e Sistemit të Planifikimit të Integruar dhe përgatitet nga Ministria e Financave. KMF ka për qëllim përcaktimin e përparësive strategjike të Qeverisë. Ai projekton pritshmërinë makroekonomike në horizontin kohor afatmesëm, si dhe parashikon nivelin e zërave të agreguar të të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit të shtetit. Ai përcakton synimet dhe objektivat e qeverisë në lidhje me treguesit kryesor të politikës fiskale si: balancën e përgjithshme fiskale (deficitin), huamarrjen, borxhin publik, balancën fiskale primare e atë korrente. KMF shërben si pikënisje për përcaktimin e tavaneve për të filluar procesin e përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2018-2020 në nivel ministrie.

KMF fillestar miratohet nga Këshilli i Ministrave në muajin janar (ose shkurt) të çdo viti, dhe është subjekt rishikimi dhe përditësimi, nëse ka ndryshime substanciale, në dy momente kyç gjatë vitit: (i) në muajin qershor, përpara finalizimit të PBA-së dhe të tavaneve të PBA-së për shpenzimet, si dhe (ii) në muajin tetor, përpara dërgimit në Parlament të projekt-buxhetit të shtetit.

KMF përbëhet nga dy komponentë kryesore: (i) parashikimet për treguesit kryesorë makroekonomik, të cilët paraqesin pritshmërinë ekonomike për vitin aktual dhe tre vitet e ardhshme dhe (ii) parashikimet dhe objektivat për treguesit fiskal sipas buxhetit të konsoliduar, të cilët paraqesin burimet e pritshme në dispozicion të qeverisë për vitet 2018-2020 dhe shpërndarjen e tyre për këtë periudhë.

Zhvillimet Makroekonomike

Zhvillimet në ekonominë e huaja

Vlerësimet e fundit të bëra nga Eurostat për tremujorin e dytë të vitit 2017² tregojnë se ekonomia e Eurozonës ka shënuar një rritje pozitive (prej 0.6%); ndërsa EU-28 është rritur me 0.7% përgjatë të njëjtit tremujor të këtij viti, krahasur me një tremujor më parë. Krahasuar më një tremujor të një viti më parë, Podhimi i Brëndshëm Bruto u rrit me 2.3% (për vendet e Eurozonës) dhe me 2.4% (për vendet e EU-28).

Kjo rritje, konsiderohet si një nga rritjet më domethënëse që prej performancës pozitive përgjatë tremujorit të parë të vitit 2015, e gjeneruar kryesisht nga investimet fikse dhe konsumi individëve. Rritja u përshpejtua në të gjitha shtetet, porsidomos në Gjermani (2.1%), Spanjë (3.1%) dhe Francë (1.7%). Disa prej ekonomive kryesore (vendet fqinje me Shqipërinë) si Greqia dhe Italia shënuan nivelin prej 0.8% dhe 1.5% për të dy këto shtete përgjatë tremujorit të dytë të vitit 2017. Ndërkohë, disa nga ritmet pozitive në lidhje me performancën e Prodhimit të Brëndshëm Bruto u shfaqën në vendet periferike të Eurozonës (Bullgaria me rritje 3.6% dhe Rumani me rritje 5.7%).

Aktiviteti ekonomik në Shqipëri është drejtpërsëdrejti i ndikuar nga ecuria ekonomike në mjedisin ndërkombëtar, veçanërisht në partnerët e saj tregtarë si: Italia dhe Greqia, kryesisht nëpërmjet eksporteve drejt tyre, remitancave, si dhe Investimeve të Huaja Direkte (IHD-të). Si pasojë e krizës globale, normat e rritjes u ulën ndjeshëm edhe në Shqipëri. Rritja reale në vitin 2009, u përgjysmua nga trendi i saj historik, por megjithatë, ndryshe nga pjesa dërrmuese e vendeve të tjera, rritja në Shqipëri vijoi të ishte pozitive, si rezultat i ekspozimit të kufizuar financiar në tregjet ndërkombëtare si dhe të një politike fiskale ekspansioniste adekuate të iniciuar para krizës. Aktiviteti ekonomik në vend u ndikua nga pasojat negative të krizës në Eurozonë, veçanërisht në vendet fqinje si: Italia dhe Greqia. Eksportet, remitancat dhe në një farë mase investimet e huaja direkte (IHD-të) ranë, duke u

¹ Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal 2018–2020 i miratuar nga Këshilli i Ministrave me VKM nr. 47, datë 25.01.2017;

² Sipas vlerësimeve të EUROSTAT - Tremujori i dytë (botuar më 7 shtator 2017);

kthyer në kanalet kryesore të transmetimit të goditjeve të jashtme në ekonomi. Rritja ekonomike regjistroi normën e saj më të ulët prej 1.1% në vitin 2013.


Në sajë të një rikuperimi të kërkesës së brendshme në reflektim të përmirësimit të besimit të agjentëve ekonomik, si dhe e mbështetur nga politika të shëndosha fiskale dhe reformave strukturore, ekonomia rimori një farë impulsi pozitiv. Rritja ekonomike u përshpejtua gradualisht duke arritur deri në rreth 3.37% në vitin 2016, e gjeneruar kryesisht nga një rritje e konsumit dhe investimeve private. Sipas vlerësimit të Ministrisë së Financave të pasqyruara në Kuadrin Makroekonomik dhe Fiskal 2018 – 2020, rritja ekonomike për vitin 2017 parashikohet të vijojë përshpejtimin gradual të saj në rreth 3.9%. Ndërsa për tre vitet në vijim 2018-2020 parashikohet një rritje mesatare prej rreth 4.3%.

Inflacioni në Eurozonë shënoi nivelin 1.5% (në terma vjetore) përgjatë muajit nëntor 2017, në rritje prej nivelit 1.4% që u shënuar në muajin paraardhës (tetor 2017). Çmimi i energjisë shënoi ritmin më të lartë me rreth 4.7% në muajin nëntor 2017, e ndjekur nga grupi ushqime, alkool dhe cigare me 2.2%, e më pas me grupin Shërbime me 1.2% dhe nga grupi i të mirave jo-industriale me një nivel prej 0.4% përgjatë muajit nëntor 2017. Vlerat e shënuara për inflacionin në Eurozonë rezultuan të ishin vlerat më të ulëta që prej muajit dhjetor të vitit 2016 dhe po ashtu, këto vlera faktike ishin më të ulëta se parashikimet e bëra nga ekspertet, duke vijuar të qëndronin poshtë nivelit të targetuar prej 2% nga Banka Qëndrore Europiane. Përgjatë muajit nëntor 2017, midis shteteve anëtare të Bashkimit Europian dhe Eurozonës, normat më të larta të inflacionit u shënuan në Estoni (4.2%), Mbretëria e Bashkuar (3.1%) dhe Letonia (me 4.4%), ndërkohë që nivelet më të ulëta u shënuan në Irlandë (0.5%) dhe Zvicër (0.8%).

- Zhvillimet në Shqipëri

Sektori real

Përgjatë vitit 2017 ekonomia e shqipërisë ka treguar sërish shenja pozitive për ecurinë ekonomike në vend. Në gjysmën e parë të vitit 2017, ekonomia në vend u rrit me 4.03%, krahasuar me të njëjtën periudhë të një vitit më parë. Kontributin më të lartë e shënuan sektorët e Ndërtimit (me 1.52 pikë përqindje) dhe sektori i Tregtisë me pakicë dhe shumicë (me 0.5 pikë përqindje). Ndërkohë, ekonomia në tremujorin e dytë të vitit 2017 u rrit me 4.06%, kundrejt tremujorit të dytë të vitit 2016. Ndërsa për tremujorin e parë të vitit 2017, kundrejt tremujorit të njëjtë të vitit 2016, ekonomia shënoi një rritje prej 3.98%. Gjysma e parë e vitit 2017 tregoi ritme pozitive dhe përshpejtuese të rritjes ekonomike (po ashtu edhe në të dy tremujorët e parë dhe të dytë të vitit) duke qëndruar mbi rritjen e saj potenciale prej 3%. Grafiku i mëposhtëm pasqyron ecurinë ekonomike në vend që prej vitit 2006 deri në gjysmën e parë të vitit 2017 (sipas vlerësimeve më të fundit nga INSTAT).



Nga pikëpamja e ofertës agregate, përgjatë gjysmës së parë të vitit 2017 degët e tjera me kontributin kryesor në rritjen e PBB ishin: 'Industria' me +0.67 pikë përqindje dhe 'Administrata publike dhe mbrojtja, arsimit, shëndetësia' me 0.45 pikë përqindje. Ndërkohë aktiviteti me kontribut negativ në rritje ishte ai i 'Arte, argëtim dhe çlodhje' me vlerën -0.06 pikë përqindje.

Tabela më poshtë paraqet rritjen dhe kontributin e çdo sektori prej tyre në rritjen ekonomike përgjatë gjysmës së parë të vitit 2017 (dhe për tremujorin e dytë 2017).

| Sipas metodës së prodhimit | Rritja | Kontributi | Rritja | Kontributi |
|---|------------------------|-------------|----------------------|-------------|
| | (në % TII-17 / TII-16) | | (në % 6M-17 / 6M-16) | |
| Bujqësia, pyjet dhe peshkimi | 0.13 | 0.16 | 0.55 | 0.12 |
| Industria | 6.05 | 0.69 | 5.12 | 0.67 |
| Ndërtimi | 22.68 | 1.84 | 19.09 | 1.52 |
| Tregtia me shumicë dhe me pakicë etj | 3.54 | 0.52 | 3.42 | 0.50 |
| Informacioni dhe komunikacioni | 2.04 | 0.05 | 1.23 | 0.03 |
| Aktivitetet financiare dhe të sigurimit | 10.60 | 0.27 | 13.16 | 0.35 |
| Aktivitetet të pasurive të paluajtshme | 0.93 | 0.05 | 0.56 | 0.04 |
| Aktivitetet shkencore, profesionale dhe teknike | -2.31 | -0.13 | 0.99 | 0.05 |
| Administrata publike dhe mbrojtja; arsimit; shëndetësia etj | 4.27 | 0.43 | 4.07 | 0.45 |
| Arte, argëtim dhe çlodhje, akt. të prodhimit të mallrave të familjeve | -4.57 | -0.11 | -2.49 | -0.06 |
| Taksat mbi produktet | 2.20 | 0.29 | 3.83 | 0.48 |
| Subvencionet mbi produktet | 59.60 | 0.00 | 32.27 | 0.04 |
| PBB totale | 4.06 | 4.06 | 4.03 | 4.03 |

Burimi: INSTAT, Shtator 2017

Nga pikëpamja e kërkesës agregate, rritja ekonomike përgjatë gjysmës së parë të vitit 2017 në tërësi është ushqyer kryesisht nga Kërkesa e Brendshme, si Konsumi final me një kontribut prej rreth 2.81 pikë përqindje, ashtu edhe Investimet totale me një kontribut prej rreth 1.7 pikë përqindje. Po ashtu, eksportet neto ka patur një performancë pozitive (me rritje prej 8.01% gjatë 6M-I 2017) me një kontribut të lehtë pozitiv prej rreth 0.63 pikë përqindje. Kryesisht rritja e besimit në ekonomi dhe kushtet më të favorshme financiare kanë mbështetur rritjen e konsumit dhe të investimeve private përgjatë gjysmës së parë të vitit 2017.

Tabela më poshtë paraqet rritjen e çdo komponenti të Kërkesës agregate, si dhe kontributin e secilit prej tyre në rritjen ekonomike përgjatë gjysmës së parë të vitit 2017 (dhe tremujorit të dytë 2017).

| Sipas metodës së shpenzimeve | Rritja | Kontributi | Rritja | Kontributi |
|---|------------------------|-------------|----------------------|-------------|
| | (në % TII-17 / TII-16) | | (në % 6M-17 / 6M-16) | |
| Konsumi Final | 2.68 | 1.31 | 2.65 | 1.28 |
| Konsumi Privat | 2.27 | 0.98 | 2.18 | 0.91 |
| Konsumi Administratës Publike | 5.75 | 0.33 | 6.56 | 0.39 |
| Investimet Bruto | 14.28 | 1.79 | 12.86 | 1.66 |
| Kërkesa e Brendshme | 4.95 | 3.05 | 4.59 | 2.81 |
| Eksportet Neto | 8.14 | 0.81 | 8.01 | 0.63 |
| Eksportet e Mallrave dhe Shërbimeve (FoB) | 17.19 | 2.54 | 15.00 | 2.49 |
| Importet e Mallrave dhe Shërbimeve (FoB) | 6.39 | -1.58 | 5.76 | 1.40 |
| PBB Totale | 4.06 | 4.06 | 4.03 | 4.03 |





Burimi: INSTAT, Shtator 2017

Të dhënat e papunësisë sipas Anketës Tremujore të Forcave të Punës (LFS) tregojnë një rritje të punësimi dhe rënie të normës së papunësisë, si gjatë vitit 2016, ashtu edhe gjatë tremujorit të tretë të vitit 2017. Norma zyrtare e papunësisë³ në tremujorin e tretë të vitit 2017 për grupmoshat 15-64 vjeç ishte 14%, kundrejt 15.2% që ishte për të njëjtin tremujor të një viti më parë. Edhe për grupmoshën e punës 15 vjeç e lart, shkalla e papunësisë zyrtare në tremujorin e tretë të 2017 shënoi vlerën prej 13.6%. Numri i personave të papunë në moshë pune (15-64 vjeç) në tremujorin e tretë të vitit 2017 ishte 187,857 persona.

³ Norma e papunësisë e regjistruar për grupmoshën 15-64 vjeç sipas klasifikimit të Anketës së Tregut të Forcës së Punës (ATFP të INSTAT) për tremujorin e parë të vitit 2017;


DOKUMENTI I PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2018–2020

Në tremujorin e tretë të vitit 2017 numri të punësuarve në moshë pune (15-64 vjeç) ishte 1,156,776 persona. Krahasuar me të njëjtin tremujor të një viti më parë (T3-2016), numri i personave të punësuar, u rrit me 14,404 persona ose 1.3%.



Sektori Monetar

Konvergimi gradual i ekonomisë drejt potencialit të saj të rritjes, ka shtyrë gradualisht edhe nivelin e inflacionit drejt nivelit të targetuar. Kështu, përgjatë periudhës janar-nëntor 2017 inflacioni mesatar rezultoi të ishte në nivelin 2.0%, nga 1.3% që ishte inflacioni mesatar për vitin 2016 në tërësi. Në grafikun më poshtë paraqitet ecuria e çmimeve për 3 vitet e fundit.



Burimi: INSTAT, dhjetor 2017

Bazuar në dinamikën e inflacionit, si edhe në parashikimet afatmesme për inflacionin dhe rritjen ekonomike, politika monetare ka vazhduar të jetë stimuluese. Norma bazë e interesit aktualisht është në nivelin më të ulët historik prej 1.25%.

Gjatë muajit Tetor të vitit 2017, stoku total i kredive bankare pati një rritje me 0.3% me muajin Tetor të vitit 2016. Gjatë muajit Tetor të vitit 2017, sasia e re kredisë së dhënë nga sistemi bankar në Lek shënoi një rënie prej 27% kundrejt muajit paraardhës (Shtator) dhe një rënie prej 7.6% kundrejt të njëjtit muaj të një viti më parë (Tetor 2016). Ndërkohë sasia e re e kredisë së dhënë në Euro u zvogëlua me 23.7% krahasuar me një muaj më parë (Shtator), dhe u rrit me 20.8% krahasuar me të njëjtin muaj të një viti më parë (Tetor 2016). Në aspektin sektorial, zgjerimi i kredisë është i përqëndruar tek segmenti i individëve, ndërkohë që kreditimi i bizneseve shfaqet i ngadaltë, i ndikuar si nga kërkesa e dobët e bizneseve, ashtu dhe nga oferta e shtrënguar e sektorit bankar.

Rezultatet e Vrojtimit të Aktivitetit Kreditues për tremujorin e tretë të vitit 2017 tregojnë se standardet e kredisë janë shtrënguar për bizneset ndërsa janë lehtësuar për individët. Sipas madhësisë së biznesit vihet re se standardet e kreditimit për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme kanë mbetur të lehtësuara njësoj si një tremujor më parë, ndërsa në segmentin e ndërmarrjeve të mëdha standardet janë shtrënguar. Për individët, standardet e kredisë rezultuan të lehtësuara, si në segmentin e kredisë për blerje banesa, ashtu edhe për kredinë konsumatore. Rënia e kostos së financimit në lekë, e cila në një masë të qënësishme reflekton edhe politikën fiskale konsoliduese dhe kërkesën e kontrolluar të qeverisë për huamarrje në tregun e brëndshëm, politikat e kreditimit të bankave, kombinuar edhe me ndërgjegjësimin e agentëve ekonomikë për rrezikun e ekspozimit ndaj kursit të këmbimit, janë materializuar në rritjen e kredidhënies në lekë. Rënia në nivelin 14.78% e raportit të kredive me probleme në muajin shtator tregon se bilancet e sektorit bankar po përmirësohen dhe se rreziku i kreditimit po vjen drejt reduktimit. Në Tetor 2017 rezultoi se rreth 49.3% e totalit të stokut të kredive përbëhet nga kreditë në Lekë, ndërsa pjesa tjetër prej 50.7% përbëhet nga kreditë në valutë. Kreditimi në monedhën vëndase krijon më shumë hapësira për transmetimin e stimullit monetar në ekonomi, si dhe redukton rreziqet e euroizimit për stabilitetin financiar.

Gjatë muajit Tetor të vitit 2017 stoku total i depozitave bankare u rrit me 0.28% krahasuar me Tetorin e vitit 2016. Stoku total i depozitave në Lekë ka shënuar një rënie prej 2.1%, ndërsa ai në valutë është rritur me 2.5% krahasuar me të njëjtin muaj të vitit 2016. Në Tetor 2017 rezultoi se rreth 46.83% e totalit të stokut të depozitave përbëhet nga depozitat në Lekë, ndërsa pjesa tjetër prej 53.17% përbëhet nga depozitimet në valutë të huaja.

Tregjet financiare janë karakterizuar nga nivele të kënaqshme likuiditeti dhe nga prime të ulëta rreziku. Në linjë me politikën monetare lehtësuese, normat e interesit të kredive dhe depozitave kanë vijuar të luhaten pranë niveleve të ulëta. Ndërkohë, kurba e yield-eve është zhvendosur lehtësisht për lart, e diktuar nga një kërkesë më e ulët e investitorëve, ndërsa primet e rrezikut kanë mbetur të pandryshuara. Normat e interesit të tregut ndërbankar kanë vijuar të luhaten në nivele të ulëta gjatë tremujorit të tretë të vitit. Tregu ndërbankar është karakterizuar nga një situatë e mirë likuiditeti, e cila ka mbështetur këtë ecuri të normave të interesit. Transmetimi i politikës monetare lehtësuese të Bankës së Shqipërisë në kosto të ulët të financimit të aktivitetit bankar ka krijuar premisa për norma më të ulëta interesi për kreditë dhënë sektorit privat. Interesi mesatar për kredinë e re në lekë rezultoi 6.8% në tremujorin e tretë, duke shënuar një rritje të lehtë nga tremujori i dytë (6.4%). Në harkun kohor të një viti, normat kanë rënë ndjeshëm për kreditë për biznese, me rreth 1.1 pikë përqindje për kreditë për likuiditet dhe me 1.6 pikë përqindje për kreditë për investime. Ato kanë mbetur në të njëjtat nivele për kreditë konsumatore dhe hipotekare. Yield-et e bonove dhe të obligacioneve të thesarit kanë vijuar ecurinë graduale rritëse. Raporti i kërkesës së investitorëve ndaj ofertës së qeverisë në ankandet e bonove, ndonëse më i lartë se 1, ka rezultuar në rënie në krahasim me tremujorin e mëparshëm, duke qenë kështu faktor në prirjen rritëse të yield-eve në këtë periudhë. Analiza e ecurisë së yield-eve tregon se rritja ka qenë e përmbajtur dhe e shpërndarë tek të gjitha maturitetet e tregtuara.

Interesi mesatar për bonot e thesarit 12-mujore u rrit në 2.31% në muajin shtator, nga 2.05% që shënonte në muajin qershor. Në ankandin e kryer në javën e parë të muajit tetor, yield-i i bonos 12-mujore ka shënuar sërish rritje, duke rezultuar 2.46%. Ecuria e yield-eve të obligacioneve ka ndjekur atë të yield-eve të bonove të thesarit. Yield-i i obligacionit 2-vjeçar u rrit në 2.99% në ankandin e fundit në muajin tetor, nga 2.55% që rezultoi në muajin qershor. Yield-et e obligacioneve 5- dhe 10-vjeçare rezultuan përkatësisht 5.28% dhe 7.0%, nga 4.64% dhe 6.90% që kishin shënuar në ankandet paraardhëse përkatëse. Përfundim nga kjo sjellje bëri yield-i i obligacionit 7-vjeçar, i cili shënoi një rënie të lehtë në 5.35%, nga që ishte 5.39% në ankandin paraardhës.


Politika e huamarrjes së qeverisë ka qenë e orientuar drejt instrumenteve afatgjata edhe në tremujorin e tretë të vitit 2017, duke i shërbyer në këtë mënyrë zgjatjes së maturitetit të borxhit të brëndshëm. Huamarrja në tregun e brëndshëm, përveç se e moderuar, ka qenë gjithashtu e diversifikuar si në terma të instrumenteve ashtu edhe të monedhës.

Leku ka vazhduar të forcohet edhe gjatë tremujorit të tretë të vitit, por me ritme më të përmbajtura. Mbiçmimi vjetor i lekut në terma nominalë efektivë, pasi kulmoi në periudhën qershor – gusht në nivelin 5.3%, u zbut në 5.1% në muajin shtator. Kjo ecuri është diktuar nga mbiçmimi më i vogël i lekut kundrejt monedhës evropiane, ndërkohë që kundrejt monedhave të tjera të shportës, leku ka vijuar të forcohet me ritme të njëjta. Në terma realë, mbiçmimi i lekut ka qenë më i moderuar krahasuar me mbiçmimin nominal në tremujorin e tretë të vitit, si rrjedhojë e një inflacioni më të ulët në vend krahasuar me atë mesatar në vendet partnere. Mbiçmimi real vjetor i lekut ka zbritur në 4.6% në muajin shtator, nga 5.6% që rezultoi në muajin qershor.

Sektori i jashtëm

Eksportet për periudhën janar-nëntor 2017, më specifikisht për eksportet e mallrave, referuar statistikave të tregtisë së jashtme (INSTAT), shënuan një rritje pozitive prej 13.2% (në terma vjetorë). Gjithashtu është e rëndësishme të evidentohet se që prej muajit gusht 2016 rritja e eksporteve totale të mallrave ka kaluar në territor pozitiv. Kontributin kryesor në rritjen vjetore të eksporteve për njëmbëdhjetëmujorin e ka dhënë grupi “Materiale ndërtimi dhe metale” me +5,2 pikë përqindje.


Në grafikun e mëposhtëm paraqitet rritja mujore e totalit të eksporteve në përqindje, kundrejt të njëjtit muaj të një viti më parë, për tre vitet e fundit.



Importet e mallrave për periudhën janar-nëntor 2017 shënuan rritje prej 8.0% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Në rritjen vjetore të importeve ka ndikuar më tepër grupi “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +2.3 pikë përqindje.

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet rritja mujore e totalit të importeve në përqindje, kundrejt të njëjtit muaj të një viti më parë, për tre vitet e fundit.

DOKUMENTI I PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2018–2020



Deficiti tregtar për periudhën janar-nëntor 2017 është përkeqësuar me 4.1%, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Norma e mbulimit të eksporteve ndaj importeve për këtë periudhë është 44.4%. Aktiviteti eksportues i vendit vijon të mbështetet kryesisht në partnerë tregtarë si: Italia, Kosova, Greqia, Gjermania, Spanja dhe Malta. Në anën tjetër, origjina e produkteve të importuara prej vendit tonë vijon të mbetet më e larmishme, ku vendet e BE-së zënë peshën kryesore ndaj totalit.

DOKUMENTI I PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2018– 2020

Treguesit fiskal të konsoliduar 2015-2020

| Nr. | E M E R T I M I | Faktik 2015 | Ne % te PBB | Faktik 2016 | Ne % te PBB | I pritahmi 2017 | Ne % te PBB | Buxheti 2018 | Ne % te PBB | Buxheti 2019 | Ne % te PBB | Buxheti 2020 | Ne % te PBB |
|------|---|----------------|----------------|----------------|----------------|--------------------|----------------|-----------------|----------------|-----------------|----------------|-----------------|----------------|
| I. | TOTALI TE ARDHURAVE | 379,206 | 26.6% | 407,021 | 27.6% | 438,401 | 28.2% | 464,702 | 28.2% | 493,850 | 28.1% | 527,051 | 28.1% |
| I. | Te ardhura nga ndihmat | 11,215 | 0.8% | 14,639 | 1.0% | 13,800 | 0.9% | 14,500 | 0.9% | 15,500 | 0.9% | 15,500 | 0.8% |
| | <i>Nga te cilat : mbeshetje buxhetore</i> | | 0.0% | 0 | 0.0% | 3,000 | 0.2% | 2,500 | 0.2% | 2,500 | 0.1% | 2,500 | 0.1% |
| II. | Te ardhura tatimore | 342,308 | 24.0% | 369,884 | 25.1% | 400,201 | 25.7% | 424,445 | 25.7% | 451,885 | 25.7% | 483,650 | 25.8% |
| II.1 | Nga Tatimet dhe Doganat | 258,882 | 18.1% | 275,780 | 18.7% | 299,400 | 19.3% | 317,597 | 19.2% | 338,750 | 19.3% | 362,797 | 19.4% |
| | Tatimi mbi Vleren e Shtuar | 125,783 | 8.8% | 131,390 | 8.9% | 141,200 | 9.1% | 151,634 | 9.2% | 161,336 | 9.2% | 173,207 | 9.2% |
| | Tatimi mbi Fitimin | 24,968 | 1.7% | 29,151 | 2.0% | 29,200 | 1.9% | 34,323 | 2.1% | 35,740 | 2.0% | 38,343 | 2.0% |
| | Alcoizat | 39,027 | 2.7% | 41,896 | 2.8% | 46,700 | 3.0% | 49,000 | 3.0% | 53,809 | 3.1% | 57,626 | 3.1% |
| | Tatimi mbi te Ardhurat Personale | 29,661 | 2.1% | 31,412 | 2.1% | 36,200 | 2.3% | 37,300 | 2.3% | 39,775 | 2.3% | 42,549 | 2.3% |
| | Taksa Nacionale dhe te tjera | 33,647 | 2.4% | 35,794 | 2.4% | 39,700 | 2.6% | 38,340 | 2.3% | 41,081 | 2.3% | 44,043 | 2.4% |
| | Taksa Doganore | 5,796 | 0.4% | 6,137 | 0.4% | 6,400 | 0.4% | 7,000 | 0.4% | 7,010 | 0.4% | 7,030 | 0.4% |
| II.2 | Te ardhura nga Pushteti Vendor | 11,700 | 0.8% | 14,951 | 1.0% | 17,400 | 1.1% | 18,787 | 1.1% | 19,983 | 1.1% | 21,326 | 1.1% |
| | Taksa Lokale | 5,746 | 0.4% | 9,675 | 0.7% | 11,646 | 0.7% | 10,345 | 0.6% | 10,804 | 0.6% | 11,330 | 0.6% |
| | Tatimi mbi Pasurine (ndertesat) | 3,921 | 0.3% | 4,678 | 0.3% | 5,272 | 0.3% | 8,139 | 0.5% | 8,757 | 0.5% | 9,446 | 0.5% |
| | Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit te vogel | 2,033 | 0.1% | 598 | 0.0% | 483 | 0.0% | 302 | 0.0% | 422 | 0.0% | 550 | 0.0% |
| II.3 | Te ardhurat nga Fondet Speciale | 71,726 | 5.0% | 79,153 | 5.4% | 83,400 | 5.4% | 88,062 | 5.3% | 93,152 | 5.3% | 99,528 | 5.3% |
| | Sigurimi Shoqesor | 60,148 | 4.2% | 66,688 | 4.5% | 70,268 | 4.5% | 74,656 | 4.5% | 79,458 | 4.5% | 84,950 | 4.5% |
| | Sigurimi Shendetesor | 9,595 | 0.7% | 10,820 | 0.7% | 11,132 | 0.7% | 11,906 | 0.7% | 12,694 | 0.7% | 13,577 | 0.7% |
| | Te ardhurat per kompensimin ne vlere te pronareve | 1,983 | 0.1% | 1,645 | 0.1% | 2,000 | 0.1% | 1,500 | 0.1% | 1,000 | 0.1% | 1,000 | 0.1% |
| III. | Te ardhura Jotatimore | 25,683 | 1.8% | 22,498 | 1.5% | 24,400 | 1.6% | 25,757 | 1.6% | 26,465 | 1.5% | 27,901 | 1.5% |
| | Tran.Fitimi nga Banka e Shqiperise | 951 | 0.1% | 1,095 | 0.1% | 1,000 | 0.1% | 1,000 | 0.1% | 1,000 | 0.1% | 1,000 | 0.1% |
| | Te ardhura nga Institucionet Buxhetore | 17,183 | 1.2% | 15,001 | 1.0% | 15,470 | 1.0% | 15,977 | 1.0% | 16,455 | 0.9% | 17,596 | 0.9% |
| | Dividenti | 528 | 0.0% | 83 | 0.0% | 800 | 0.1% | 800 | 0.0% | 820 | 0.0% | 845 | 0.0% |
| | Tarifat e Sherbimeve | 2,519 | 0.2% | 2,738 | 0.2% | 3,300 | 0.2% | 3,400 | 0.2% | 3,480 | 0.2% | 3,500 | 0.2% |
| | Te tjera | 4,502 | 0.3% | 3,581 | 0.2% | 3,830 | 0.2% | 4,580 | 0.3% | 4,710 | 0.3% | 4,960 | 0.3% |
| I. | TOTALI I SHPENZIMEVE | 437,408 | 30.6% | 433,697 | 29.4% | 469,101 | 30.2% | 497,069 | 30.1% | 523,629 | 29.8% | 549,762 | 29.4% |
| I. | Shpenzime Korrente | 350,752 | 24.6% | 368,720 | 25.0% | 387,770 | 24.9% | 407,981 | 24.7% | 432,482 | 24.6% | 454,215 | 24.3% |
| 1 | Personeli | 72,489 | 5.1% | 67,540 | 4.6% | 75,130 | 4.8% | 78,898 | 4.8% | 81,940 | 4.7% | 84,940 | 4.5% |
| | Paga | 62,492 | 4.4% | 58,215 | 4.0% | 58,890 | 3.8% | 64,784 | 3.9% | 67,369 | 3.8% | 69,469 | 3.7% |
| | Kontributi per Sigurime Shoqerore | 9,997 | 0.7% | 9,325 | 0.6% | 10,340 | 0.7% | 11,114 | 0.7% | 11,571 | 0.7% | 12,171 | 0.6% |
| | Fondi i vecante i pagave | | | | | 400 | 0.0% | 500 | 0.0% | 500 | 0.0% | 500 | 0.0% |
| | Politika te reja pagash | | | | | 5,500 | 0.4% | 1,000 | 0.1% | 1,000 | 0.1% | 1,300 | 0.1% |
| | Arsimi i Larte nga te ardhurat e veta | | | | | | | 1,500 | 0.1% | 1,500 | 0.1% | 1,500 | 0.1% |
| 2 | Interesat | 38,643 | 2.7% | 36,259 | 2.5% | 37,900 | 2.4% | 41,500 | 2.5% | 47,500 | 2.7% | 50,969 | 2.7% |
| | Te Brendshme | 27,385 | 1.9% | 25,526 | 1.7% | 22,000 | 1.4% | 25,000 | 1.5% | 30,200 | 1.7% | 31,269 | 1.7% |
| | Te Huaja | 11,258 | 0.8% | 10,733 | 0.7% | 11,900 | 0.8% | 12,500 | 0.8% | 12,300 | 0.7% | 13,700 | 0.7% |
| | Kontingjencet per risqet e borzhit | | | | | 4,000 | 0.3% | 4,000 | 0.2% | 5,000 | 0.3% | 6,000 | 0.3% |
| 3 | Shpenzime Operative Mirembajtje nga te cilat: | 42,409 | 3.0% | 44,329 | 3.0% | 44,887 | 2.9% | 45,520 | 2.8% | 47,107 | 2.7% | 47,462 | 2.5% |
| | <i>Te qeverisjes qendrore</i> | | | | | 39,987 | 2.6% | 41,720 | 2.5% | 43,107 | 2.5% | 43,162 | 2.3% |
| | <i>Arsimi i Larte nga te ardhurat e veta</i> | | | | | 3,000 | 0.2% | 1,800 | 0.1% | 1,900 | 0.1% | 2,000 | 0.1% |
| | <i>Te tjera jashte limitit</i> | | | | | 1,900 | 0.1% | 2,000 | 0.1% | 2,100 | 0.1% | 2,300 | 0.1% |
| 4 | Subvencionet | 1,735 | 0.1% | 1,725 | 0.1% | 2,330 | 0.1% | 2,090 | 0.1% | 2,090 | 0.1% | 2,090 | 0.1% |
| 5 | Shpenzime per Fondet Speciale | 141,166 | 9.9% | 152,591 | 10.4% | 161,522 | 10.4% | 170,485 | 10.3% | 182,540 | 10.4% | 193,485 | 10.3% |
| | Sigurime Shoqerore | 107,309 | 7.5% | 114,276 | 7.8% | 117,000 | 7.5% | 124,265 | 7.5% | 131,500 | 7.5% | 139,565 | 7.5% |
| | Politika te reja pensionesh | | | | | 2,600 | 0.2% | 1,820 | 0.1% | 2,940 | 0.2% | 3,120 | 0.2% |
| | Sigurime Shendetesore | 32,695 | 2.3% | 34,796 | 2.4% | 38,122 | 2.5% | 40,400 | 2.4% | 43,100 | 2.5% | 45,300 | 2.4% |
| | Shpenzime per Kompensimin ne Vlere te Pronareve | 1,162 | 0.1% | 3,519 | 0.2% | 3,800 | 0.2% | 4,000 | 0.2% | 5,000 | 0.3% | 5,500 | 0.3% |
| 6 | Shpenzime per Buxhetin Vendor | 34,066 | 2.4% | 43,580 | 3.0% | 42,900 | 2.8% | 46,188 | 2.8% | 47,505 | 2.7% | 50,069 | 2.7% |
| | Granti nga buxheti i shteti per pushtetin vendor | 22,366 | 1.6% | 28,629 | 0.0% | 22,350 | 1.4% | 24,001 | 1.5% | 23,972 | 1.4% | 25,093 | 1.3% |
| | <i>Fond i pakushtezuar</i> | | | | | 15,635 | 1.0% | 16,380 | 1.0% | 16,672 | 0.9% | 17,793 | 0.9% |
| | <i>Grant Specifik</i> | | | | | 6,715 | 0.4% | 7,421 | 0.4% | 7,300 | 0.4% | 7,300 | 0.4% |
| | Te ardhura nga taksat dhe tarifat vendore | 11,700 | 0.8% | 14,951 | 1.0% | 17,400 | 1.1% | 18,787 | 1.1% | 19,983 | 1.1% | 21,326 | 1.1% |
| | Buxheti Vendor (Te ardhura nga taksat e ndara) | | 0.0% | | 0.0% | 350 | 0.0% | 600 | 0.0% | 650 | 0.0% | 650 | 0.0% |
| | Buxheti Vendor (Nga te ardhurat jo-tatimore) | | 0.0% | | 0.0% | 2,800 | 0.2% | 2,800 | 0.2% | 2,900 | 0.2% | 3,000 | 0.2% |
| 7 | Shpenzime te tjera | 20,244 | 1.4% | 22,696 | 1.5% | 23,100 | 1.5% | 23,300 | 1.4% | 23,800 | 1.4% | 25,200 | 1.3% |
| | Pagesa e Pagesise | 615 | 0.0% | 691 | 0.0% | 600 | 0.0% | 800 | 0.0% | 800 | 0.0% | 1,000 | 0.1% |
| | Ndihma Ekonomike dhe Pasfesia | 17,662 | 1.2% | 20,026 | 1.4% | 20,500 | 1.3% | 20,500 | 1.2% | 21,000 | 1.2% | 22,000 | 1.2% |
| | Kompensim per ish te pernejskurit politike | 1,967 | 0.1% | 1,979 | 0.1% | 2,000 | 0.1% | 2,000 | 0.1% | 2,000 | 0.1% | 2,200 | 0.1% |
| II. | Fondi Rezerve | 0 | 0.0% | 0 | 0.0% | 2,700 | 0.2% | 2,700 | 0.2% | 3,300 | 0.2% | 3,300 | 0.2% |
| | Fondi Rezerve | | | | | 2,200 | 0.1% | 1,700 | 0.1% | 1,500 | 0.1% | 1,500 | 0.1% |
| | Rezerve per reformen ne Drejtesi | | | | | 500 | 0.0% | 1,000 | 0.1% | 1,800 | 0.1% | 1,800 | 0.1% |
| III. | Shpenzime Kapitale | 63,059 | 4.4% | 59,478 | 4.0% | 74,131 | 4.8% | 86,388 | 5.2% | 87,847 | 5.0% | 92,247 | 4.9% |
| | Financimi Brendshem | 38,133 | 2.7% | 39,118 | 2.7% | 47,761 | 3.1% | 55,178 | 3.3% | 50,305 | 2.9% | 54,305 | 2.9% |
| | <i>Nga e cila: Fondi per infrastrukturen vendore dhe rajonale</i> | | | | | 8,900 | 0.6% | 7,000 | 0.4% | 7,000 | 0.4% | 7,000 | 0.4% |
| | Investime nga te ardhurat e Arsimit te Larte | | | | | 1,000 | 0.1% | 700 | 0.0% | 1,100 | 0.1% | 1,200 | 0.1% |
| | Financimi Huaj | 24,926 | 1.7% | 20,360 | 1.4% | 25,370 | 1.6% | 30,510 | 1.8% | 36,442 | 2.1% | 36,742 | 2.0% |
| | <i>nga te cilat: Energjia</i> | | | | | | | 3,300 | 0.2% | 2,500 | 0.1% | 2,500 | 0.1% |
| IV | Detryrimet e prapambetura | 17,597 | 1.2% | | | | | | | | | | |
| | Detryrimet e infrastruktures | 6,111 | 0.4% | | | | | | | | | | |
| | Detryrimet tatimore | 5,666 | 0.4% | | | | | | | | | | |
| | FSDKSH | 5,820 | 0.4% | | | | | | | | | | |
| V | Huadhenie Neto per Energjine | 1,000 | 0.1% | 5,499 | 0.4% | 4,500 | 0.3% | 0 | 0.0% | 0 | 0.0% | 0 | 0.0% |
| | Hua e dhene per Energjine | 1,000 | 0.1% | | | 6,000 | 0.4% | 0 | 0.0% | 0 | 0.0% | 0 | 0.0% |
| | Hua e kthyer nga sistemi energjistik | | | | | 1,500 | -0.1% | | | | | | |
| VI | Fond Shpronosimi | 5,000 | 0.4% | | | 500 | 0.0% | | | | | | |
| | DEFICITI | -58,202 | -4.1% | -26,676 | -1.8% | -30,700 | -2.0% | -32,366 | -2.0% | -29,779 | -1.7% | -22,711 | -1.2% |
| | FINANCIMI DEFICITIT | 58,202 | 4.1% | 26,676 | 1.8% | 31,199 | 2.0% | 32,366 | 2.0% | 29,779 | 1.7% | 22,711 | 1.2% |
| | Brendahem | -6,403 | -0.4% | 9,176 | 0.6% | 20,929 | 1.3% | 41,947 | 2.5% | 22,637 | 1.3% | 21,374 | 1.1% |
| | Te ardhura nga privatizimi | 877 | 0.1% | 2,805 | 0.2% | 350 | 0.0% | | | | | | |
| | Hua-marje e brendshme | -17,268 | -1.2% | 10,602 | 0.7% | 20,579 | 1.3% | 29,947 | 1.8% | 22,637 | 1.3% | 21,374 | 1.1% |
| | Te tjera | 9,988 | 0.7% | -4,231 | | | | 12,000 | 0.7% | 0 | 0.0% | 0 | 0.0% |
| I | Huaj | 64,605 | 4.5% | 17,500 | 1.2% | 10,270 | 0.7% | -9,581 | -0.6% | 7,142 | 0.4% | 1,337 | 0.1% |
| | Hua afatgjate (e marre) | 17,832 | 1.2% | 18,780 | 1.3% | 17,570 | 1.1% | 18,510 | 1.1% | 41,642 | 2.4% | 103,742 | 5.5% |
| | Ndryshimi i gjendjes se arkies | -2,992 | -0.2% | -408 | 0.0% | | | | | | | | |
| | Ripagjest | -61,693 | -4.3% | -21,998 | -1.5% | -28,300 | -1.8% | -35,091 | -2.1% | -39,500 | -2.3% | -102,405 | -5.5% |
| | Mbeshetje buxhetore | 111,458 | 7.8% | 21,126 | 1.4% | 21,000 | 1.4% | 7,000 | 0.4% | 5,000 | 0.3% | 0 | 0.0% |
| | Produkti i Brendshem Bruto (PBB) | 1,427,799 | 100% | 1,472,791 | 100% | 1,555,202 | 100% | 1,649,952 | 100% | 1,754,992 | 100% | 1,872,979 | 100% |

C. Kërkesat Buxhetore Afatmesme sipas Programeve të Ministrive të Linjës

